



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 807/6 prot.

Tiranë, më 07 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 229, datë 07 . 11 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 140 Regj., datë 11.07.2023, paraqitur nga subjekti ankues G. M, kundër Autoritetit Portual Durrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të: “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore” dhe “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara pranë Komisionerit, nga subjekti ankues, G. M, ajo ka shpjeguar se:

“Autoriteti Portual Durrës (APD) ka shpallur në faqen zyrtare vendin vakant për “Specialist Auditues të Brendshëm”, për herë të parë në vitin 2021, dhe pasi nuk kishte asnjë të interesuar për këtë pozicion pune, ai u rishpall sërish në muajin janar 2022. Gjatë kësaj shpalljeje, kam shprehur interesin duke u bërë pjesë e konkurimit për këtë pozicion pune dhe kam depozituar gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Për këtë procedurë ishim ofruar dy konkurentë dhe kandidati tjetër u tërhoq për arsye të punësimit diku tjetër, duke mbetur vetëm unë kandidaturë e vetme dhe që plotësoja të gjitha kushtet e kualifikimet. Në vijim, nuk pata asnjë njoftim të mëtejshëm për këtë procedurë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

Në muajin mars 2023, u rishpall për herë të tretë, në faqen zyrtare të ADP-së, i njëjti pozicion për të cilin unë kisha kandiduar në shpalljen e dytë të tij. Përsëri shpreha interesin tim për këtë pozicion duke qenë kandidatja e vetme në përmbushje të të gjitha kërkesave të cituara me ndryshimin e vetëm të kriterëve nga shpallja e mëparshme që kandidatët të kishin mbi 3 vite eksperiencë në Administratën Publike, përkundrajt 10 viteve eksperiencë të shpalljes së mëparshme.

Lidhur me aplikimin për pozicionin e shpallur kam dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm me datë 13.03.2023 (në kuadër të procedurës së shpallur nga APD, me datë 03.03.2023 për pozicionin vakant të “Specialistit pranë Njësisë së Auditimit të Brendshëm”).

Ka kaluar një kohë relativisht e gjatë për një procedurë rekrutimi, gati 18 muaj, përfshirë të dyja procedurat e shpallura dhe në faqen e ADP nuk ka patur asnjë njoftim lidhur me këtë shpallje.

Për këtë arsye me datë 15.06.2023 kërkova shkresërisht nga APD, të informohesha lidhur me ecurinë e procedurës së rekrutimit për pozicionin për të cilin unë kisha konkuruar”.

Ankuesja shprehet se përgjigjja e dërguar nga APD, nuk ka ezauruar kërkesat dhe pyetjet që ajo ka ngritur para këtij autoriteti lidhur me procedurën e konkurimit në fjalë.

Ankuesja ka informuar Komisionerin se, personi që është përzgjedhur në pozicion e punës për të cilin ajo kishte konkuruar me të, ka një moshë më të re krahasuar me të (ankuesja është e moshës 54 vjeç), dhe për këtë shkak ajo pretendon se është diskriminuar. Ajo shprehet gjithashtu se:

“Pretendoj për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, pasi personi që është punësuar në pozicionin për të cilin kam aplikuar është punonjëse e brendshme e institucionit të APD, ndërsa unë jam punonjëse e Administratës Publike.

Diskriminohem për shkak të gjendjes arsimore, pasi unë plotësoj të gjitha kushtet e përgjithshme apo të veçanta të rekrutimit, jam e pajisur me Certifikatën e Auditit të Brendshëm, kam arsimimin e kërkuar dhe kualifikimin e trajnimit e duhura në funksion të zbatimit të detyrave funksionale për atë pozicion pune.”

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga ana e APD, dhe të ndërmarrë masat për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimeve diskriminuese kundrejt saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”*, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

.....b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 807/2 prot., datë 13.07.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Autoritetit Portual Durrës (APD), si dhe dokumentacion provues, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
 - Nëpërmjet shkresës me nr. 2067/1 prot., datë 24.07.2023, Komisioneri është njohur me qëndrimin institucional të APD-së, përse i takon pretendimit të ankueses.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 807/4 prot., datë 31.07.2023, Komisioneri i është drejtuar sërish APD-së, me qëllim marrjen e informacionit më të plotë, i cili nuk ishte vënë në dispozicion të KMD-së me shkresën e mësipëme të APD-së.
 - Nëpërmjet shkresës me nr. 2067/3 prot., datë 07.08.2023, APD, dërgoi kopje të dokumentacionit të kërkuar nga KMD-ja, i cili ndodhet i depozituar në dosjen e ankueses.
3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri,

nëpërmjet shkresës me nr. 807/5 prot., datë 02.10.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, e cila ishte planifikuar të zhvillohej në datën 18.10.2023, pranë Zyrës së Komisionerit.

4. Nëpërmjet emailit të datës 10.10.2023, APD, ka kërkuar që seanca të shtyhet për një datë tjetër, për shkak të pamundësisë objektive të përfaqësueses ligjore të saj, për të marrë pjesë në këtë datë.
5. Komisioneri pasi ka konsideruar sa më sipër, ka vlerësuar mundësinë për zhvillimin e seancës në një datë të dytë dhe ka njoftuar palët, se seanca do të shtyhej.
6. Në një komunikimi tjetër vijues nëpërmjet e-mailit, palët janë njoftuar për zhvillimin e seancës në datën 02.11.2023, ora 10:00.
7. Nëpërmjet e-mailit datë 27.10.2023, APD ka konfirmuar pjesëmarrjen në seancën e dates 02.11.2023, ndërsa subjekti ankues ka njoftuar nëpërmjet e-mailit po me datë 27.10.2023, se ndodhet jashtë territorit të Shqipërisë për një afat të pacaktuar, dhe se nuk mund të jetë e pranishme në seancë por u qëndron të njëjtave parashtrime si në ankesën fillestare.
8. Ankueses iu bë e ditur, se, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve për një proces të rregullt ligjor, pas zhvillimit të seancës asaj do t'i komunikohet një kopje e procesverbalit të mbajtur gjatë seancës, si dhe do t'i bëhet i njohur qëndrimi i APD-së gjatë seancës, gjë për të cilën në vijim, ajo do të mund të paraqesë objeksionet e saj nëpërmjet e-mailit, nëse do të ketë të tilla.
9. Seanca dëgjimore u realizua me praninë e përfaqësueses së APD-së, në mungesë të subjektit ankues, e cila kishte komunikuar nëpërmjet e-mailit, për pamundësinë e saj objektive për të qenë e pranishme. Gjatë seancës përfaqësuesja e APD-së mbajti të njëjtin qëndrim si ai i komunikuar shkresërisht në datat 24.07.2023 dhe 07.08.2023, si dhe dha shpjegime për sa u pyet në seancë, duke lënë njëkohësisht edhe një afat kohor prej 10 ditësh për sqarimin e kërkesave të përfaqësuesve të Komisionerit.
10. Nëpërmjet e-mailit datë 02.11.2023, ankueses iu komunikuan nga ana e inspektorit të çështjes, qëndrimi dhe parashtrimet e APD-së, si dhe iu dërgua për njohje procesverbali i mbajtur gjatë seancës dëgjimore. Palës iu bë e ditur se nëse do të kishte objeksione lidhur me qëndrimin e APD-së, mund t'i paraqiste nëpërmjet e-mailit pranë KMD-së.
11. Në vijim të sa më sipër, subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit datë 06.11.2023³, ka falenderuar Komisionerin për angazhimin e tij dhe punën e bërë për trajtimin e çështjes së saj, dhe ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës pranë KMD-së, për arsye personale, duke cituar ndër të tjera se:

³ Depozituar në dosjen e ankueses, në cilësi prove.

“Në vijim të e-mailit tuaj datë 02.11.2023, përsa më përket mua nuk kam asnjë kërkesë ndaj APD-së, ndaj në falenderim të punës tuaj mund ta konsideroni të zgjidhur dhe të mbyllur çështjen në këtë pikë të saj, pasi nuk kam asnjë pretendim ndaj APD-së dhe Komisioneri do të mund ta vlerësojë këtë si një arritje efektiviteti, duke e konsideruar si një vendim themeli pa pritur përfundimin e afatit 90 ditor.

...Për arsye personale tërhiqem nga ankesa që kam paraqitur pranë KMD-së kundër APD-së, për rekrutimin tim, ndaj mund ta quani të përfunduar këtë çështje...”

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”,* KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94⁴/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, shtetasja G. M, e cila, me anë të kërkesës datë 06.11.2022, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 06.11.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 140 regj., datë 11.07.2023, të paraqitur nga ankuesja G. M kundër Autoritetit Portual Durrës, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

⁴ *“Tërheqja e ankesës”.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 140 Regj., datë 11.07.2023, paraqitur nga subjekti ankues G. M, kundër Autoritetit Portual Durrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të: “*gjendjes arsimore*”, “*gjendjes shoqërore*” dhe “*moshës*”, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA